



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
AKADEMIA E TË RINJVE E SHQIPËRISË - ALBANIAN YOUNG ACADEMY

THIRRJE PËR KONFERENCË

Akademia e të Rinjve e Shqipërisë, me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizon konferencën shkencore ndërkombëtare të kërkuesve të rinj me temë: **“Teknologjia, Inteligjenca Artificiale (IA) dhe Transformimi i Kërkimit Shkencor”**.

Konferenca do të zhvillohet në datë **3 dhjetor 2024** pranë **Akademisë së Shkencave të Shqipërisë** dhe synon gjithëpërfshirjen e kërkuesve të rinj brenda dhe jashtë vendit. Thirren të marrin pjesë në këtë aktivitet shkencor të gjithë kërkuesit e rinj deri në 10 vite pas përfundimit të doktoraturës, ose në proces të studimit doktorat.

Kjo konferencë është një mundësi për të gjithë lektorët, studiuesit e rinj nga universitetet, institucionet kërkimore, por edhe për përfaqësuesit nga bizneset dhe agjenci të tjera publike dhe private. Përmes saj, synohet të thellohet debati shkencor rreth ndikimit të inteligjencës artificiale dhe teknologjisë në fushën e kërkimit shkencor, duke adresuar situatën e re të kërkimit shkencor në epokën e Inteligjencës Artificiale, jo vetëm duke e përshkruar këtë dinamikë, por edhe duke ngritur problematika të reja, si bie fjala: etika dhe përdorimi i IA në kërkimin shkencor, ndërthurja e metodave tradicionale me ato moderne etj. Përmes propozimeve dhe diskutimeve, konferenca synon të çojë përpara debatin shkencor për një çështje kaq të rëndësishme dhe aktuale. Pjesëmarrësit inkurajohen të kontribuojnë në diskutimin rreth ndikimit të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në kërkimin shkencor.

- **Formati i konferencës** do të jetë **hibrid**: me pjesëmarrje fizike dhe online, për t'u dhënë mundësi pjesëmarrjeje akademikëve të rinj që punojnë jashtë vendit.
- Punimet mund të paraqiten në formën e prezantimeve ose me poster.
- Pranohen prezantime të punimeve shkencore në trajtën e “Review” (përmbledhje, recensa).
- Konferenca nuk ka tarifë regjistrimi.



Disa prej **fushave bosht**, dhe **principeve** të kësaj konference janë:

1. Roli dhe ndikimi e Inteligjencës Artificiale në Kërkimin Shkencor: Diskutimi mbi transformimin e metodologjive dhe rezultateve në shkencat natyrore, shoqërore dhe humane.
2. Automatizimi dhe Përmirësimi i Efikasitetit në Kërkimin Shkencor: Shqyrtimi i teknologjive të reja, duke përfshirë inteligjencën artificiale, dhe ndikimin e tyre në rritjen e efikasitetit dhe saktësisë së proceseve hulumtuese.
3. Etika dhe Rregullimi i Përdorimit të Inteligjencës Artificiale në Kërkimin Shkencor: Diskutimi mbi çështjet etike dhe ligjore që shoqërojnë përdorimin e inteligjencës artificiale në kërkim, përfshirë përgjegjësinë shoqërore dhe mbrojtjen e privatësisë së të dhënave.
4. Ndikimi i Inteligjencës Artificiale në Edukim dhe Krijimtari Shkencore: Analizimi i ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe stimulimit të inovacionit në kërkim, për shkak të teknologjive të reja dhe inteligjencës artificiale.
5. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Inteligenca Artificiale në Kërkimin Shkencor: Shqyrtimi i mundësive për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e dijeve, duke përdorur inteligjencën artificiale dhe teknologjitë e tjera inovative.
6. Kjo konferencë synon të nxisë ndërdisiplinaritetin në kërkimin shkencor, kjo pasi pikëtakimet e fushave të ndryshme kërkimore gjithnjë e më tepër janë pjesë e realitetit tonë akademik.
7. Gjithëpërfshirja, strategji e kësaj konference, me qëllimin për të inkurajuar pjesëmarrjen e një spektri të gjerë akademikësh dhe kërkuesish.

Disiplinat shkencore që mund të përfshihen në këto tematika janë:

- Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)
 - Shkencat Natyrore dhe Inxhinierike (STEM)
 - Shkencat Shoqërore dhe Humanitetet
 - Bujqësia dhe Bioteknologjia
 - Shëndetësia dhe Shkencat e Jetës
 - Edukimi dhe Arsimi
 - Shkencat e zbatuara
- (Kjo listë e disiplinave ka për qëllim orientimin dhe jo kufizimin e pjesëmarrësve në konferencë.)*

Data dhe të dhëna të tjera të rëndësishme:

	Afati / Deadline	Adresa e-mail
Dorëzimi i abstrakteve	25 tetor 2024	albya@akad.gov.al
Data e zhvillimit të konferencës	03 dhjetor 2024	
Dorëzimi i punimeve të plota	23 Dhjetor 2024	albya@akad.gov.al

*Abstraktet duhet të dorëzohen në adresën zyrtare albya@akad.gov.al deri më 25 Tetor 2024. Nëse propozimi pranohet, punimi i plotë duhet të dërgohet brenda datës 23 Dhjetor 2024 në të njëjtën adresë email-i.

- Thirrja për pjesëmarrje në këtë konferencë është e hapur për gjithë akademikët dhe kërkuesit e rinj deri në 10 vite pas përfundimit të doktoraturës, si dhe për kërkuesit e rinj në proces të studimit doctoral.

Gjuhët në të cilat do të zhvillohet konferenca:

- Gjuhët e referimit në konferencë do të jenë shqipja dhe anglishtja.
- Abstraktet duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe angleze, ose vetëm në gjuhën angleze për pjesëmarrësit e huaj.
- Artikujt e plotë mund të jenë në shqip ose në anglisht.

Aktet e konferencës do të botohen në një nga dy gjuhët (shqip ose anglisht), në revistën periodike të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë (Journal of the Albanian Young Academy. Volume 1; 2019). Revista e Akademisë së të Rinjve ka një kod ISBN dhe artikujt e plotë do të kalojnë procesin e “shqyrtimit të fshehtë” (blind review) nga bordi shkencor, përpara se të përfshihen në botimin përfundimtar. Po ashtu, ato do të publikohen në faqen e internetit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Udhëzime për paraqitjen e abstrakteve/përmbledhjeve:

- Fusha e Kërkimit: Përcaktoni fushën dhe disiplinën shkencore të studimit tuaj.
- Titulli: Në shkronja kapitale në Times New Roman, madhësia 12. Pozicionimi në mes të faqes (center) dhe bold.
- Emrat e Autorëve dhe afiliacionin: Shkruajini emrat dhe mbiemrat e plotë të autorëve me shkronja kapitale, përcaktuar në Times New Roman, madhësia 10, adresat korresponduese të institucioneve ku autorët punojnë dhe zhvillojnë kërkimin shkencor, duke përfshirë emrin e universitetit, fakultetit, departamentit, qytetit, shtetit, poshtë mbiemrit.

- Teksti i Abstraktit:** Teksti duhet të jetë në Times New Roman, madhësia 12, pa shkronja kapitale. Përshkruani temën e studimit, qëllimin, metodologjinë (nëse aplikohet), rezultatet kryesore dhe përfundimet. Përmbledhja duhet të jetë midis 250 - 300 fjalëve.
- Fjalët Kyçe:** Shkruajini fjalët kyçe në Times New Roman, madhësia 10, me shkronja të pjerrëta (italik), jo më shumë se 5 të tilla.
- Dorëzimi i Propozimeve:** Abstraktet duhet të dorëzohen në adresën zyrtare albya@akad.gov.al deri më 25 Tetor 2024. Nëse propozimi juaj pranohet, punimi i plotë duhet të dërgohet brenda datës 23 Dhjetor 2024 në të njëjtën adresë email.

Udhëzime për artikullin e plotë për publikim:

Formati i Tekstit: Artikulli i plotë duhet të paraqitet në formatin Microsoft Word. Nuk duhet të jetë më i gjatë se 12 faqe format A4 (210 x 297 mm), përfshirë tabela, grafika, figura dhe shënime të tjera.

Formatimi i Tekstit:

- Hapësira anës shkrimit duhet të jetë 2.54 cm ose 1 inç.
- Teksti duhet të jetë justify, me hapësirë single-spaced midis rreshtave.
- Hapësira e parë e secilit paragraf duhet të jetë e njëjtë.
- Madhësia dhe lloji i shkrimit duhet të jetë 12-pt, lloji: Times New Roman.

Tabelat dhe Figurat: Secila tabelë dhe figurë duhet të ketë një titull specifik. Përshkruani tabelat dhe figurat në mënyrë që të mos nevojitet të referohen shpesh tek teksti. Të dhënat shtesë duhet të jepen për sqarim në fund të tabelës ose figurës.

Artikulli i plotë duhet të përfshijë këto pjesë kryesore:

- Përmbledhja/Abstrakti: Paraqet një përmbledhje të shkurtër të studimit, duke përfshirë rëndësinë e tij dhe qëllimin.
- Hyrja: Përshkruani informacionin e përgjithshëm të subjektit të studimit dhe objektivat e tij. Specifikoni qëllimin e studimit në fund të këtij seksioni.
- Materialet dhe Metodot: Detajoni procedurat eksperimentale dhe protokollin e ndjekur në mjaftueshmëri për ta riprodhuar studimin nga të tjerët. Përfshini metodat statistikore dhe nivelin e rëndësisë së tyre.

- Rezultatet dhe Diskutimet: Sigurojini të dhëna të qarta dhe të lehta për t'u kuptuar. Rezultatet duhet të paraqiten në mënyrë logjike dhe koncize. Diskutimi duhet të interpretojë gjetjet e reja në studim.
- Përfundimet: Përfundimet duhet të japin një pasqyrë të shkurtër të gjetjeve dhe të interpretimit të tyre.
- Falënderimet: Përfshijeni bashkëpunimet dhe kontributet e personave që kanë ndihmuar në studim, si dhe informacionin lidhur me burimet e financimit.
- Referencat: Citoni referencat në tekst duke përdorur një sistem të renditur me numra në kllapa katrore, *për shembull: "Studimi nga [1] tregon se..."*. Përfshijeni të gjitha referencat e cituara në seksionin e Referencave.
- Në seksionin e Referencave, ato do të jenë me numër rendor, sipas formatit: **[1] Mbiemri, Emri i autor(it)ëve** shkruhen me germa "Bold"; "Titulli i Punimit", Emri i Revistës/Monografisë, Numri i Revistës, Viti i Botimit, Numri i Faqeve, Vendi i Botimit.

Sigurohuni që të ndiqni këtë format për çdo referencë që përdorni në punimin tuaj për të siguruar një prezantim të qartë dhe të standardizuar të burimeve të cituara.

Dërgimi i Dorëshkrimit:

- Dorëshkrimi duhet të jetë një punim origjinal dhe të përshtatet me udhëzimet e specifikuar.
- Dërgohet si dokument i bashkëlidhur në adresën zyrtare të email: albya@akad.gov.al brenda datës 23 dhjetor 2024

Letër Shoqëruese (Cover Letter):

- Deklaroni se dorëshkrimi nuk është publikuar diku tjetër dhe nuk po konsiderohet për publikim diku tjetër.
- Specifikoni konflikte të mundshme të interesit dhe siguroni që të gjithë autorët kanë aprovuar dorëshkrimin përfundimtar.

Ju lutem, kontrolloni që dorëshkrimi juaj të përmbushë këto kushte përpara se ta dërgoni. Nëse keni ndonjë pyetje shtesë ose nevojë për ndihmë, mos hezitoni të pyesni!

Struktura për shkrimin e një artikulli "Review"

Përmbledhja/ Abstrakti: Duhet të përmbajë rreth 200-300 fjalë dhe duhet të paraqesë një përmbledhje të shkurtër të pyetjeve të ngritura mbi temën e caktuar, studimet kryesore që janë marrë në konsideratë dhe konkluzionet e arritura.

Hyrja: Përfshin prezantimin e çështjes së zgjedhur dhe këndvështrimin e autorit duke theksuar rëndësinë e trajtimit të saj. Duhet të

shprehen qartësisht pikat që artikulli do të diskutojë, duke ruajtur radhën që ndiqet në vazhdim të tekstit si dhe çdo informacion bazë që do t'i nevojitet lexuesit për të kuptuar vijën logjike të autorit.

Trupi:

Përfshin të gjitha nënçështjet e nevojshme për t'ju përgjigjur dhe për të diskutuar pyetjet e ngritura. Duhet të ketë ndarje të informacionit në seksione për të pasqyruar qartësisht këndvështrimet e autorit. Në secilin rast, autori duhet të përshkruajë me kujdes dhe të vlerësojë në mënyrë kritike informacionet e marra nga artikujt shkencorë, metodat e përzgjedhura prej tyre etj.

Konkluzionet:

Duhet të ndërtohen duke ripërsëritur shkurtimisht bazat e këtij punimi dhe rëndësinë e tij. Më pas, vazhdon me diskutimin e konkluzioneve duke përfshirë zbatimin e tyre dhe mendimin e autorit mbi rrugën që duhet ndjekur në të ardhmen për një zhvillim të mëtejshëm të kërkimit shkencor në fushën e trajtuar.

Ju faleminderit për interesimin, presim me padurim kontributet tuaja në këtë konferencë të rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe përparimin e shkencës.

Me respekt,

Bordi Shkencor:

Aulon Shabani
Belfjore Zifla
Shaniko Allajbeu
Joniada Barjaba
Resul Telhaj
Erald Sino